



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E APELIT TIRANË



ANALIZË VJETORE

2013

ANALIZË VJETORE

JANAR 2014

PËRMBAJTJA

Hyrje

<i>Fjala e Kryetarit</i>	2
<i>Gjykata e Apelit Tiranë në vitin 2013</i>	4
<i>Raportet me median</i>	9
<i>Përmbledhje e çështjeve të gjykuara për vitin 2013</i>	16
<i>Cilësia në Gjykim</i>	19
<i>Ngarkesa e gjyqtareve</i>	22
<i>Shpejtësia në Gjykim</i>	24
<i>Administrimi i fondeve për vitin 2013</i>	25
<i>Sfida dhe propozime për vitin 2014</i>	28
<i>Aktivitet që janë zhvilluar në vitin 2013</i>	32

Hyrje

I nderuar zoti President i Republikës, Bujar NISHANI,

I nderuar Zv.Kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, z. Elvis ÇEFA,

I nderuar Ministër i Drejtësisë, Z. Nasip NAÇO,

I nderuar Kryeprokuror i Apelit, z. Shkëlqim Hajdari,

Të nderuar kolegë pjesëmarrës,

Më lejoni **Zoti President** që, në emër të trupës gjyqësore të Gjykatës së Apelit të Tiranës t’Ju shpreh falenderimet dhe konsideratat më të larta për pjesëmarrjen Tuaj në këtë analizë vjetore.

Kam nderin që për të dytin vit rradhazi të paraqes veprimtarinë e Gjykatës së Apelit Tiranë, duke prezantuar të gjithë aktivitetin një vjeçar, në respektim dhe përmbushje të detyrimeve ligjore në zbatim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit mbi “Organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor në Shqipëri”.

Analiza vjetore e 2013-ës pasqyron një përmbledhje të aktiviteteve të kësaj Gjykate gjatë vitit që sapo lamë pas dhe gjithashtu në një farë mënyrë tregon se sfidat e Gjykatës së Apelit Tiranë në kuadër të rritjes së besimit dhe transparencës tek publiku shqiptar. Këto arritje janë mundësuar falë përkushtimit të gjithë anëtarëve të Gjykatës, Kancelarit, Kryesekretarisë, Sekretareve gjyqësore dhe të gjithë personelit mbështetës të kësaj Gjykate. Dëshiroj t’i falënderoj të gjithë, për përpjekjet e vazhdueshme dhe punën e palodhur, me qëllim arritjen e objektivave të caktuara nga vetë ne.

Si kryetar i kësaj gjykate dhe duke vepruar gjithmonë i udhëhequr nga fryma e bashkëpunimit, sigurisht që përcjell sot edhe kenaqësinë e gjithsecilit prej nesh, për arritjet dhe rezultatet shumë të mira të një viti të gjatë pune.

Si Kryetar i Gjykatës së Apelit dhe në ushtrim të detyrës time si gjyqtar, jam i ndërgjegjshëm për të rritur angazhimin në ndërmarrjen e iniciativave sa më të efektshme në drejtim të forcimit të një gjykate jo vetëm të pavarur e të paanshme, por dhe më efektiv në dhënien e drejtësisë, me synimin përfundimtar, rritjen e besimit të publikut në këtë pushtet kaq të rëndësishëm.

Në këtë vit është shënuar një progres i dukshëm lidhur me përdorimin e pajisjeve të teknologjisë së informacionit, me të cilat është siguruar përpunimi i shpejtë i informacionit dhe njëkohësisht, nëpërmjet faqes së re zyrtare është përmirësuar aksesimi i publikut në gjykatë si dhe përhapja e informacionit juridik me anë të publikimit elektronik të vendimeve.

Nëpërmjet prezantimit me anë të këtij raporti të situatës aktuale me të cilën përballet sot kjo gjykatë, gjej rastin t'u bëj një apel të gjitha insitucioneve kompetente për të vlerësuar maksimalisht problematikat me të cilat përballet sot gjyqësori shqiptar, pra çdo hallkë e tij, të ndërmarrin hapat e duhur për të çuar përpara reformat e kërkuara. Dhënia e drejtësisë nuk është vetëm një mision i shenjtë për gjyqtarin, por njëkohësisht një obligim për këdo që ushtron pushtet, për më tepër kur ky pushtet i ka bazat tek ata që çdo ditë presin një drejtësi të shpejtë dhe të barabartë për të gjithë.

Gjykata e Apelit Tiranë në veprimtarinë e saj gjatë vitit 2013 ka patur si qëllim kryesor garantimin e një procesi të rregullt ligjor, si një e drejtë themelore dhe detyrim kushtetues. Prioritet ka qënë rritja e besimit të publikut në dhënien e drejtësisë, nëpërmjet sigurimit të aksesit në gjykatë dhe përfitimit të informacionit të plotë nga ana e qytetarëve.

Gjykata e Apelit Tiranë është institucion i pavarur, si pjesë integrale e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, i specializuar në mbledhjen, gjykimin çështjeve civile dhe penale sipas kompetencës ligjore të pranimit.

Po çfarë është bërë konkretisht në Gjykatën e Apelit Tiranë gjatë vitit 2013, dhe cilat janë sfidat për këtë vit që kemi përpara ?

Investimet e vitit 2012 -2013, kanë krijuar mundësinë e funksionimit normal të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe shërbimeve gjyqësore.

Në zbatim i dekretit të Presidentit nr. 7818, datë 16.11.2012 “Për caktimin e numrit të gjyqtarëve për çdo gjykatë të shkallës së parë, apelit dhe gjykatave administrative si dhe caktimin e kompetencave tokësore dhe selisë qendrore të gjykatave administrative” numri i gjyqtarëve të Apelit Tiranë është rritur nga 21 në 31 gjyqtarë. Kjo shtesë në burime njerëzore kërkoi dhe një strategji të re të funksionimit të gjykatës si në investime dhe shërbime gjyqësore, ashtu edhe në modelimin e aktivitetit ndërtesë, të mëparshëm, i cili ishte në gjendje aspak normale funksionimi dhe sigurie.

Në një periudhë kohore prej **një viti e gjysëm** është bërë i mundur një transformim i gjykatës në këto drejtime:

1. Krijimin e sallave të gjyqit dhe mobilim me një stil dhe standart bashkohor.
2. Krijimin dhe përdorimin e ndërtesave aktuale ish-lokal dhe zyrat e ZABGJ si dhe pjesës së lirë duke krijuar një ambjent shërbimi gjyqësor cilësor dhe të shpejtë për publikun.
3. Krijimin dhe rritjen e sigurisë dhe besimit të publikut në përballjen e parë me gjykatën. Rritjen e sigurisë së trupës gjyqësore duke ndarë fluksin gjyqtarë, prokurorë dhe administratë nga publiku dhe organet e sigurisë dhe të policisë .
4. Konsolidimin dhe eficesën e ëëbsitit të gjykatës ku çdo i interesuar merr infomacion në kohë rekord.
5. Krijimin dhe vënien në eficensë të sistemit auditimit, si një kontroll publik më i drejtë dhe me transparencë si dhe rritje e masave antikorrupsion.
6. Krijimin e kushteve mjaft komode për punonjësit e gjykatës duke ndikuar në rritjen dhe rendimentin e punës në gjykatë.
7. Krijimi dhe funksionimi i një arkivi të thjeshtë por shumë fleksibël për informacion.

Me këto investime Gjykata e Apelit Tiranë ka arritur një model të ri të drejtimit dhe menaxhimit, ka rritur standartin e shërbimit ndaj publikut, personave juridikë dhe fizikë si dhe taksapaguesve, si një model më mirë i gjithë këtyre viteve të fundit.

Gjykata ka arritur të menaxhojë në mënyrën më të mirë fluksin e shërbimit gjyqësor dhe krijimin e kushteve optimale punonjësve të gjykatës. Mbi 500 individë frekuentojnë gjykatën çdo ditë për nevoja dhe kjo menaxhohet në mënyrën më të mirë. Gjykata ka arritur një standart të lartë në orientimin e publikut dhe ofrimin e shërbimeve. Shërbimet ofrohen për publikun në çdo orë brenda orarit zyrtar të punës.

Ashtu si edhe në vite paraardhëse, Gjykata e Apelit Tiranë ka marr një sërë vendimesh të rëndësishme, ndër të cilat jo pak kanë qënë çështje me ndjeshmëri të lartë publike, të cilat pavarësisht volumit të madh u arritën të arsyetoheshin në një afat të shkurtër kohor, falë punës së palodhur të trupave gjyqësore përkatëse. Numri dhe shumëllojshmëria e çështjeve gjyqësore të zgjidhura nga gjykata gjatë vitit 2013 janë pasqyruar në rubrika të vecanta të këtij raporti, të shoqëruara me të dhëna statistikore, në lidhje me ecurinë e shqyrtimit të çështjeve të paraqitura pranë kësaj gjykate gjatë vitit 2013.

Gjatë vitit 2013, në periudhën para dhe pas zgjedhore, Gjykata e Apelit Tiranë u angazhua dhe u vu në dispozicion të plotë të punës së **Kolegjit Zgjedhor**, dy prej anëtarëve të nderuar të të cilit ishin gjyqtarë të kësaj gjykate e njëkohësisht kolegë të

respektuar të gjyqsorit në Shqipëri, të cilët karakterizohen nga profesionalizmi dhe integriteti i lartë në ushtrimin e detyres. Volumi i çështjeve me objekt mosmarrëveshje zgjedhore të depozituara në gjykatë për këtë periudhë ka qënë rreth 40 çështje. Vendimet e Kolegjit Zgjedhor janë publikuar të gjitha në faqen e internetit të Gjykatës së Apelit Tiranë në ndryshim nga disa vite më parë që vendimet e këtij kolegji nuk ishin të pasqyruara askund dhe nuk gjendeshin me lehtësi.

Gjykata e Apelit ka qënë gjithnjë promotore e instalimit dhe funksionimit të sistemit të regjistrimit audio që në fillimet e tij duke i njohur vlerat dhe potencialin e rritjes së transparencës që garanton kjo teknologji. Gjatë vitit 2013 në Gjykatën e Apelit Tiranë është realizuar me sukses **regjistrimi audio i të gjitha seancave gjyqësore**, një nga pikat e evidentuara të rëndësishme edhe nga Progres Raporti 2013 i KE për Shqipërinë. Ky sistem krijon mundësinë e rritjes së mbikqyrjes dhe kritikës së publikut ndaj gjyqsorit. Kjo reformë jo vetëm që ka përmirësuar kushtet e punës për gjyqtarët dhe administratën gjyqësore, por ka ndikuar edhe në rritjen e transparencës së procesit gjyqësor, në rritjen e integritetit e të përgjegjshmërisë së gjyqtarëve. Në Gjykatën e Apelit Tiranë, regjistrimi i seancave gjyqësore ka filluar më datë 11.04.2013. Në këtë Gjykatë sot funksionojnë 6 salla gjykimi me sistemin e regjistrimit audio. Sipas statistikave, përdorimi i sistemit të regjistrimit audio nga cdo gjyqtar i kësaj gjykate, që nga momenti i fillimit deri tani ka ardhur në rritje. Pra sot, në Gjykatën e Apelit Tiranë, ky sistem zbatohet në masën 88.2% nga të gjithë gjyqtarët. Pjesa prej 10.8 % ka të bëjë me çështjet për të cilat kishte filluar gjykimi pa sistemin audio dhe që u vendos të përfundonin ashtu sic kishin nisur. Një pjese e madhe e tyre ishin masa sigurimi të cilat kanë filluar të regjistrohen me urdhër të Kryetarit, në zbatim të udhëzimeve të Ministrisë së Drejtësisë. Në vitin 2014 pretendojmë që numri i seancave gjyqësore të regjistruara në audio të jetë në masën 100%.

Theksoj se ka një Udhëzim të Ministrit të Drejtësisë nr. 353, datë 03.09.2013 “*Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për mbajtjen, ruajtjen dhe arkivimin e procesverbalit të seancës gjyqësore me mjete audio*”, duke përcaktuar regjistrimin e detyrueshëm të seancave gjyqësore, në mbështetje të të cilit është nxjerrë edhe një Urdhër të brendshëm i Kryetarit. Me qëllim mbarëvajtjen e këtij procesi, në vijimësi janë ngritur grupe pune me urdhër të Kryetarit për verifikuar regjistrimin e seancave në sistemin audio. Ky sistem, i cili është një arritje e madhe teknologjike, ka nevojë për të ecur përpara edhe për angazhimin dhe bashkëpunimin e të gjithëve: gjyqtarëve sekretareve gjyqësore dhe specialistëve të IT.

Gjykata e Apelit, si një institucion publik, dedikuar dhënies së drejtësisë, udhëhiqet nga fryma për të ofruar një shërbim cilësor në interes të qytetarit, në zbatim të kërkesave parimore dhe përgjegjësisë ligjore, në respektim të parimit ndërkombëtar të drejtësisë, atij të një procesi të rregullt ligjor. Nëpërmjet veprimtarisë së saj, Gjykata e Apelit

Tiranë luan një rol të rëndësishëm në rritjen e besimit të publikut tek drejtësia, rritjen e integritetit moral e profesional të anëtarëve të sistemit gjyqësor, mbrojtjen e figurës së gjyqtarit dhe statusit të tij. Për këtë qëllim, i është dhënë prioritet faktit që çdo muaj **hedhja e shortit elektronik** të çështjeve gjyqësore është zhvilluar **publikisht**, në prani të qytetarëve të rastësishëm në sallën e pritjes së publikut, në prani të profesionistëve apo edhe të përfaqësuesve nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Ministria e Drejtësisë të ftuar për të marr pjesë. Risia qëndron në faktin se tashmë është arritur një barazi në numrin e çështjeve të rëna në short për të gjithë gjyqtarët, si dhe barazi të këtyre çështjeve edhe sipas objektit të tyre. Shpërndarja e çështjeve në vetvete është një nga format e luftës kundër korrupsionit dhe perceptimit të publikut në lidhje me gjykatën. Dy vjet më parë, në disa gjykime të Gjykatës së Apelit Tiranë, janë vërejtur ankesa nga palët dhe sidomos nga avokatët e shtetit në lidhje me zhvillimin e një kategorie çështjes ku bënte pjesë Avokatura e Shtetit në mbrojtje të interesave të shtetit me trupa gjykues të përcaktuar, ankesa të cilat kishin arritur deri aty sa ata deklarorin se nuk do të paraqiteshin në gjykatë nëse këto kategori çështjesh do t'i shqyrtonte ky trup gjykues. Duke marr shkas nga këto vërejtje të bëra është unifikuar procedura e hedhjes së shortit në mënyrë të barabartë. Ndërkohë që para dy vjetësh nuk ekzistonte kjo lloj barazie.

Ndarja e çështjeve në short sipas objektit të padisë është një nga kriteret kryesore në zbatim të vendimeve të KLD dhe pikërisht vendimit nr 238/1/a, dt. 24.12.2008 “*Për procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore*”, i ndryshuar me vendimin nr. 282.8, datë 16.12.2011, ku neni 3 i të cilit parashikon shprehimisht se “*Kryetari i gjykatës grupon çështjet e paraqitura sipas llojit të objektit, duke përcaktuar një radhë rastësore të regjistrimit të çështjes. Çështjet gjyqësore civile dhe penale u ndahen në mënyrë të barabartë gjyqtarëve të dhomës përkatëse apo seksionit brënda dhomës civile. Kërkesat civile, u ndahen në mënyrë të barabartë gjyqtarëve të dhomës civile, pavarësisht nga seksionet ku janë caktuar të gjykojnë. Me barazi në ndarjet e çështjeve do të kuptohet: ndarja në numër të barabartë mes gjyqtarëve, e çështjeve të ardhura për short, pavarësisht nga ngarkesa individuale e çdo gjyqtari në kohën e hedhjes së shortit*”. Unifikimi i gjykimeve sipas objekteve të padisë është pikërisht një nga format e luftës kundër korrupsionit të cilin mund ta drejtojë titullari i gjykatës për të krijuar më qartë profilin e institucionit. Fakti që në këtë mënyrë të ndarjes së shortit, sipas objektit të padisë, tashmë vendimmarrjet e gjyqtarëve nuk janë më nga një trupë gjykuese e përcaktuar, por nga e gjithë trupa gjyqësore, duke e përshtatur këtë me unifikimin e praktikës, sigurisht krijon bindja që vendimmarrja për kategori çështjesh e gjithë trupës gjyqësore është e njëjtë. Korrupsioni nuk luftohet vetëm nëpërmjet policisë së shtetit por nga të gjithë aktorët e drejtësisë, duke përshtatur procedura efikase dhe ligjore në favor të shtetasve dhe disfavor të nëpunësve të cilët kanë detyrimin e zbatimit të ligjit. Ky vendim i Këshillit të Lartë të Drejtësisë është në përputhje të plotë me

rekomandimet e Progres Raportit 2013 i Komisionit European për Shqipërinë, duke iu përqasur në këtë mënyrë standartit aq shumë të kërkuar nga KE. Në këtë mënyrë, në zbatim të vendimit të KLD dhe Progres Raportit, në këto dy vjet, i jemi shkëputur praktikës së mëparshme të vjetër dhe tepër konsumuese për institucionin e Gjykatës duke shmangur njëkohësisht krijimin e perceptimit në këtë mënyrë te publiku për përfitime të çfarëdo lloji, për një grup njerëzish, ose aktorësh të drejtësisë.

Gjykata e Apelit Tiranë në bashkëpunim me ekspertët e IT në Ministrinë e Drejtësisë dhe shoqërinë IKUB INFO, kemi arritur pikërisht heqjen e të drejtës së Kryetarit të gjykatës për të Edit-uar ose përzgjedhur vetë çështjet të cilat do të hidhen në short. Gjithashtu, konform edhe rekomandimeve të Progres Raportit 2013 të KE për Shqipërinë në Gjykatën e Apelit Tiranë është i garantuar caktimi i rastësishëm i çështjeve nëpërmjet sistemit të unifikuar të administrimit të çështjeve gjyqësore.

Shpallja e vendimeve të arsyetuara ka filluar si praktikë në këtë Gjykatë që në vitin që shkoi, fakt i cili ka krijuar një impakt pozitiv te publiku, avokatët e juristët. Në këtë mënyrë palët e interesuara kanë kohë të mjaftueshme për të kuptuar arsyet e vendimmarrjes si dhe kundërshtimin e vendimit me anë të rekursit në Gjykatën e Lartë. Impakt pozitiv ka krijuar kjo praktikë edhe te media. Ligji parashikon që në çështjet e ndërlikuara, gjykata mund të shpallë dispozitivin e vendimit dhe të shpallë më vonë me gojë vendimin e arsyetuar ose ta depozitojë atë me shkrim brenda një afati të caktuar kohor. Në të kaluarën kemi pasur disa raste ku vendimet e arsyetuara janë të dorëzuar me vonese. Situata të tilla nuk krijohen më sepse jo vetëm gjyqtarët janë ndërjegjësuar për rëndësinë e arsytimit ligjor të depozituara në kohë por dhe sepse vonesat në arsyetimin e vendimeve merren parasysh në vlerësimin e punës së një gjyqtari nga inspektorët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Gjyqtarët por edhe zyrtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë janë në një mendim mbi faktin se duhet të ruhet një ekuilibër midis një arsytimi cilësor të vendimit dhe një kohë të përshtatshme që nuk cënon të drejtat e qytetarëve.

Me qëllim unifikimin e të gjithë praktikës në lidhje me dorëzimin e vendimeve të arsyetuara dhe cilësisë së tyre, ketu gjej rastin të bëjmë një propozim Ministrisë të Drejtësisë për të marrë një nismë ligjore për ndërhyrje në Kodin e Procedurës Civile në seksionin e Gjykimit në Apel, duke vendosur **afate të përcaktuara qartë për dorëzimin e vendimeve të arsyetuara** nga gjyqtari i Apelit. Madje mosdorëzimi i vendimit të arsyetuar brenda këtij afati të konsiderohet shkelje në detyrë. Deri tani ky kriter ka qënë faktor për vlerësimin e punës së gjyqtarit duke interpretuar ligjin me analogji nga vetë Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Për të shmangur vonesat e dorëzimit, interpretimet e favorshme ose të disfavorshme të bëra për gjyqtarin, duhet që ky kriter të vendoset në rregull tashmë, të qartë dhe të detyrueshëm për t'u zbatuar. Nëpërmjet kësaj sigurohet në të njëjtën kohë edhe përcaktimi i shkaqeve konkrete të kundërshtimit

të një vendimi duke bërë një ankim apo rekurs efektiv e duke shmangur ankimimet thjesht për zënie afati nga palët e interesuara, si dhe përgjegjësia individuale e çdo gjyqtari përballë publikut dhe më tej përgjegjësia e gjykatës. Gjithashtu në këtë ndryshim ligjor të parashikohet afati i ankimit të vendimit duke filluar ky afat nga moment i dorëzimit të vendimit të arsyetuar dhe jo nga shpallja e tij, sic është aktualisht.

Duhet thënë se nga njëra anë është e vështirë të sigurohet një cilësi e mirë arsyetimi kur vendimi duhet të dorëzohet me shkrim në më pak se njëzetë ditë, ndërsa nga ana tjetër arsyetimi i vendimit nuk duhet të jetë i pranishëm vetëm formalisht por ai duhet të garantojë një zgjidhje argumentative të çështjes. Praktikrat në lidhje me arsyetimin e vendimeve janë të shumta, por në kodet tona nuk është e parashikuar një gjë e tillë. Duke qënë se kodet tona janë huazuar nga e drejta italiane, cmoj që ky ndryshim në Kodin e Procedurës Civile duhet te huazohet po nga praktika italiane. Pra arsyetimi i vendimit të bëhet brenda një muaji nga shpallja e vendimit dhe pikërisht kjo të jetë data e lidhjes së drejtës së palës për të bërë ankim. Pikërisht ky moment shumë i rëndësishëm do ti japë kohën publikut duke shtuar transparencën për të ankuar në formën dhe mënyrën e duhur vendimet gjyqësore duke i shërbyer rolit dhe mekanizmit të parashikuar në ligj për kontrollin e vendimeve gjyqësore nga të gjitha shkallët e gjykimit.

Dhënia e arsyeve të plota bashkë me vendimin siguron që përpara se vendimi të shpallet, gjyqtari të ketë bërë një vlerësim të plotë nga pikëpamja e faktit dhe ligjit për çështjen pa kompromentuar të drejtën e palëve për një gjykim të drejtë. Vonesat në dhënien e vendimeve të arsyetuara kombinuar me afatet e shkurtra për ankim mund të cenojnë kështu të drejtat kushtetuese të palëve, në këndvështrimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut.

Sa i përket **arsyetimit të vendimeve** duhet theksuar se për periudhën që po analizojmë ka një rritje të ndjeshme të cilësë në këtë drejtim në Gjykatën e Apelit Tiranë. Gjithashtu nuk vërehen vonesa në zbardhjen e vendimeve nga ana e gjyqtarëve. Kjo falë edhe ndjekjes së trajnimeve vazhduese të gjyqtarëve pranë Shkollës së Magjistraturës, si edhe trajnime të tjera brenda dhe jashtë vendit, ku gjyqtarët kanë marr pjesë. Por gjithashtu është koha që vetë gjyqtarët duhet te përcaktojnë formën e arsyetimit të vendimeve të gjykatës e cila duhet te jetë unike në të gjithë Shqipërinë.

Gjithashtu në funksion të rritjes profesionale i kemi dhënë rëndësi mbledhjeve e mëngjesit, të cilat zhvillohen me protokoll ku pasqyrohet jo vetëm pjesëmarrja e gjyqtarëve për efekt të vlerësimit, por edhe punimi i vendimeve të Gjykatës së Lartë

dhe Gjykatës Kushtetuese dhe diskutime në parim mbi qëndrimet që mbahen në gjykim në lidhje me çështje të caktuara, diskutimet mbi ligjet dhe udhëzimet e Ministrit të Drejtësisë. Falë këtij komunikimi pozitiv mes gjyqtarëve, punimit të këtyre vendimeve në gjykatën tonë janë unifikuar disa qëndrime në lidhje me gjykime të çështjeve të së njëjtës natyrë civile.

Raportet me median

Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur një sjellje e hapur ndaj medias së shkruar dhe vizive, e cila është një mekanizëm për t'u afruar më tepër në drejtim të publikut, duke qenë vetë gjykata burimi parësor i një informacioni të saktë të transmetuar nga media. **Marrëdhënia Gjyqësor-Media** është një marrëdhënie sa e domosdoshme aq dhe delikate, që për të arritur synimin e përbashkët, respektimin e të drejtës së publikut për informim, duhet që në mënyrë reciproke të respektohet pavarësia dhe integriteti i secilit pushtet. Me të vërtetë Media është tashmë, *de facto*, pushteti i katërt, që në emër të së drejtës themelore për liri të shtypit ka të drejtën për të informuar publikun mbi çështje që prekin drejtpërsëdrejti interesat e tyre, por nuk duhet harruar se ky pushtet, ashtu si dhe të tjerët, ka dhe detyrimin që të veprojë gjithmonë brenda kuadrit ligjor. Media, ashtu si gjykatat, nuk është mbi ligjin.

Dëshiroj të falenderoj mediat investigative në lidhje me kontributin e tyre në zbulimin e akteve korruptive sic ishte rasti i disa muajve më parë të shfaqur në Top Channel. Në fakt të gjithë në gjyqtarët dhe aktorët e drejtësisë, biem dakort që këto veprime të konstatuara pikërisht në ambientet e një institucioni sic është gjykata, pra në tempullin ku gjykohen të drejtat e shtetasve shqiptarë, është një skandal i madh dhe një pikëpyetje e madhe për sistemin e drejtësisë. Për këtë fakt të gjithë bashkë duhet të falenderojmë median, por gjithashtu duhet të kërkojmë edhe bashkëpunimin e saj në lidhje me ruajtjen e njëfarë anonimiti të veprimeve të cilat shihen dukshëm të cilat nuk kanë të bëjnë me gjyqtarët e prokurorët. Në kuptim më të gjerë, publikimi i emrave të gjyqtarëve dhe prokurorëve në këto emisione përvec rasteve të plota korruptive, përbën në vetvete një dëm publik të kryer ndaj pushtetit gjyqësor. Në fakt trupa gjyqësore e Republikës së Shqipërisë përbëhet nga 330 gjyqtarë efektivë, të cilët mbajnë peshë dhe presione të ndryshme sic janë ato politike, legjislative, shoqërore dhe të krimit të organizuar.

Kështu që të gjithëve publikisht na bie barra që jo vetëm ti sulmojmë por edhe ti mbrojmë. Sulmi dhe mbrojtja e tyre sigurojnë të vetmen gjë, vetëm garancinë e ruajtjes së të drejtave dhe lirive themelore që parashikohen në Konventën e të Drejtave të Njeriut, si dhe Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Në fakt nga zbatimi i të drejtave themelore të shtetasve dhe të vetë gjyqtarëve e prokurorëve, fillon vendosja e

shtetit dhe të drejtës, për të cilën ne kemi që pas viteve '90 që flasim e pretendojmë të arrijmë.

Në sistemin tonë të drejtësisë duhet të bëhet një kategorizim i gjyqtarëve në: ata që e kanë jetën të lidhur me shtetin dhe që janë të pakompromentueshëm, si dhe ata që e kanë jetën të lidhur me krimin dhe janë të korruptueshëm. Ka ardhur koha që pikërisht tani sa nuk është vonë të bëhet kjo ndarje përfundimtare në radhët e gjyqësorit dhe të fillojë një periudhë e re për sistemin e drejtësisë. Mënyrat dhe procedurat janë të thjeshta, treguesit janë të qartë për të bërë një gjë të tillë. Vlerësim, vlerësim dhe vetëm vlerësim real i punës së gjyqtarëve. Vlerësimi është i thjeshtë duke u nisur nga përqindja e çështjeve të lëna në fuqi nga gjykatat më të larta, nga llojet e çështjeve, përballja e çështjeve dhe presionit të publikut etj.

Por për vetë kategorinë më të lartë të gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit, ky vlerësim nuk mund të bëhet nga funksionarë të cilët nuk kanë punuar gjyqtarë apeli ose të kenë mbi pesë vjet punë si gjyqtar. Ky vlerësim duhet të jetë së pari i paanshëm, i drejtë dhe i vërtetë, duke u bërë kështu transparencë e plotë e veprimtarisë së gjyqtarit.

Vendimi Nr. 195/2/a, datë 05.07.2006 (Shtuar dhe ndryshuar me Vendimin Nr.207/1, datë 07.02.2007, *Rregullore "Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë"*, përcakton kushtet të cilat janë të domosdoshme për tu emëruar Inspektor. Neni 4 i këtij vendimi parashikon se: "*Kryeinspektori dhe inspektorët emërohen nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me propozim të Zëvendëskryetarit, duke u përzgjedhur ndërmjet gjyqtarëve që përmbushin kriteret për t'u emëruar gjyqtar në Gjykatën e Apelit dhe, në mungesë të tyre, ndërmjet juristëve që kanë shërbyer si gjyqtar jo më pak se 5 vjet.*"

Nga ana tjetër vendimet që merr një gjyqtar apeli, janë vendime përfundimtare dhe të ekzekutueshme, e që barazohen me fuqinë e ligjit. Prandaj, duke qënë se ka një parashikim ligjor, cmoj të theksoj me vend se ka ardhur koha që të zgjidhet përfundimisht kjo klimë e krijuar lidhur me vlerësimin e gjyqtarëve të apelit. Nuk mundet kurrsesi që vendimi i gjyqtarit të apelit, i cili barazohet me ligjin, t'i lejohej interpretimi i tij nga cilido organ administrativ, aq më tepër inspektorëve të KLD-së. Ka ardhur koha që, lidhur me këtë pjesë të bëhen ndryshime urgjente për të përcaktuar rregulla të tjera për vlerësimin e gjyqtarëve të apelit.

Në fakt, sa i drejtë dhe sa i pakompromentueshëm është një gjyqtar, duket qartë në gjykimet e çështjeve penale, ku pikërisht fillon përgjegjshmëria e tij personale me ligjin. Gjej vendin të shpreh opinionin tim, por edhe të gjithë gjyqtarëve të ndershëm, që interpretimi i vendimeve gjyqësore, është gjëja më e gabuar që mund ti ndodhë jo vetëm gjyqtarit por të gjithë sistemit të drejtësisë në Shqipëri. Kemi kaq shumë vjet që

flasim e flasim për mos përgojimin e gjyqtarëve nga vetë gjyqtarët, mos interpretimin e vendimeve gjyqësore nga vetë gjyqtarët, ndalime të cilat i njeh dhe vetë ligji, por vazhdon ende kjo histori shqiptare e shëmtuar në sistemin e drejtësisë. Madje më shumë se kurrë si në gjithë këto 20 vjet këto interpretime i kanë bërë ata që kanë përfaqësuar institucionet kyce duke marrë rolin e njerëzve të drejtësisë në Shqipëri, kur në fakt drejtësia nuk është prerogativë e një personi, por e të gjithë sistemit. Kjo mënyrë e interpretimit të vendimit të gjykatës, sidomos në prezencë të zyrtarëve më të lartë të pushteteve sic janë ekzekutivi, legjislativi dhe gjyqësori, është në fakt një “gjueti shtrigash” e ndërtuar nga persona të cilët janë të padëshirueshëm dhe shumë të përfolur nga sistemi i drejtësisë. Në fakt këtyre aludimeve të këtyre personave duhet që tu themi ne gjyqtarët së pari të heshtim dhe mandej gjithë shoqëria. Kjo mënyrë interpretimi vendimesh, ose veprimesh të gjyqtarëve, ka mbetur në fakt në të gjitha kohërat e pazbuluar dhe është presion i hapur ndaj gjyqtarëve dhe e parë në një këndvështrim më të gjerë, ndaj të gjithë sistemit gjyqsor. Duhet përfundimisht që gjyqtarët të denoncojnë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë të gjitha këto raste të cilat janë tepër të dëmshme.

Me rritjen e numrit të gjyqtareve në këtë gjykatë ka ardhur një përmirësim të kushteve të punës së gjyqtarëve, duke ulur numrin e çështjeve në gjykim për çdo gjyqtar dhe përmirësimin në mënyrë të veçantë në pjesën e gjykimit në një procedurë të saktë dhe gjykim në një kohë të shpejtë, konform standarteve të kërkuara nga KE. Nga 6 kolegje civile që kemi patur në vitin 2012, tashmë duke filluar nga muaji Shtator 2013 janë gjithsej 7 kolegje civile dhe 2 penale, ndarja e të cilëve është në funksion të ngarkesës që ka përballuar kjo gjykatë gjatë vitit 2013, dhe efikasitetit për zgjidhjen brënda afatit të arsyeshëm të ceshtjeve. Me shtimin e numrit të gjyqtarëve lindi nevoja e krijimit të disa zyrave shtesë duke bërë një rikonstrukcion të pjesshëm të godinës së gjykatës, duke marr edhe hapësirat në të cilat ushtronte veprimtarinë ZABGJ. Si rezultat është krijuar edhe një sallë tjetër gjykimi duke u bërë në total **6 salla gjykimi**.

Gjykata e Apelit Tiranë në veprimtarinë e saj ka patur dhe ka si qëllim sigurimin e transparencës së plotë të gjykatës ndaj publikut si dhe thjeshtimin sa më shumë të shërbimeve që ofron gjykata. Drejtësia është një shërbim i rëndësishëm publik, prandaj është e drejtë e publikut të monitorojë e ta kontrollojë atë në çdo hap të saj. **Gjykata e Apelit Tiranë** ka në shërbim të publikut **Zyrën e Informacionit** duke treguar një kujdes të veçantë në lidhje me kërkesat e qytetarëve për ti kthyer përgjigje zyrtare në kohën e duhur. Gjithashtu në funksion të rritjes së transparencës, funksionon rregullisht në faqen e internetit të gjykatës një adresë email-i, ku adresohen probleme të ndryshme që mund të ngrihen nga qytetarët lidhur me veprimtarinë e Gjykatës.

Në përgjithësi, përgjatë dy viteve të fundit, jemi munduar t'i japim prioritet **gjyqimit të çështjeve në orarin e caktuar**, pa vonesa si dhe shpalljen e listave të gjyqimit në vendet e përcaktuara pranë tabelave të gjykates (dhe në faqen e internetit). Në këtë mënyrë kemi arritur një imazh shumë pozitiv për gjykatën si dhe kemi krijuar kushte lehtësuese të publikut për marrjen e informacionit të plotë nga gjykata. Publikimi i vendimit në faqen e internetit i krijon mundësi palëve në proces (dhe të tretëve) për tu njohur në kohë me arsyetimin e vendimit të kësaj gjykate, në funksion të realizimit të ngritjes së pretendimeve të tyre në Gjykatën e Lartë. Faqja e internetit është në çdo kohë e aksesueshme për të gjitha llojet e çështjeve që gjykohen në këtë gjykatë (me lidhjet ndihmese) dhe me lehtësi në marrjen e informacionit. Nga statistikat rezulton se në vitin 2013 ka patur rreth **800.000 vizitorë në faqen tonë të internetit**, me një mesatare prej **70.000 vizitorë në muaj**. Sektorët më të klikuar nga përdoruesit janë Sektori i kalendarit të çështjeve gjyqësore dhe sektori i shpalljes së vendimeve gjyqësore.

Publikimi i vendimeve gjyqësore të marra në Gjykatën e Apelit Tiranë, është i garantuar plotësisht, duke marr parasysh të gjitha aspektet që lidhen me mbrojtjen e të dhënave personale, konform ligjit nr.9887, datë 10.03.20058 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, Udhëzimit të Nr.15, dt.23.12.2011 "Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor" të Komisionerit për Mbrojtjen e të dhënave personale". Në publikimin e këtyre vendimeve kemi ndjekur rekomandimet përkatese të Komisionerit për Mbrojtjen e të dhënave personale duke anonimizuar ato të dhëna që përbëjnë cënim të të dhënave personale. Në këtë mënyrë kemi përmbushur edhe rekomandimin e Progres Raportit 2013 të KE për Shqipërinë.

Opinionin publik është forma më e mirë e kontrollit ndaj punës së gjykatësve dhe ne duhet të punojmë në drejtimin e rritjes së mëtejshme të transparencës së gjykatave ndaj publikut.

Në këtë kontekst një rol thelbësor luan edhe parimi kushtetues i publicitetit të vendimeve, gjithashtu i rëndësishëm, në rritjen e nivelit të transparencës është edhe publikimi on-line i vendimeve dhe aksesit i dokumenteve zyrtare ndaj publikut të gjerë. Në këtë mënyrë publiku mund të ushtroj drejtëpërsëdrejti kontrollin mbi punën e gjykatave në transparencë të plotë. Natyrisht e drejta e informimit, aksesit të dokumenteve zyrtare dhe e transparencës së organeve shtetërore nuk duhet të çënohet nga ana tjetër të drejtën e privatësisë së qytetarëve. Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale përcakton se cilat janë të dhënat sensitive personale dhe mënyrën e përpunimit e mbrojtjes së tyre. Gjykata e Apelit Tiranë në zbatim edhe të rekomandimeve të Progres Raportit 2013 të KE për Shqipërinë, në bashkëpunim me Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është bërë promotore e mbrojtjes së të dhënave sensitive të palëve pjesëmarrëse në gjyq. Këto të dhëna personale

sensitive, në të gjitha kategoritë e vendimeve shkurtohen dhe aty ku është e mundur kodohen. Por është e domosdoshme të theksohet se për vetë natyrën publike të procesit tonë gjyqësor dhe për vetë rëndësinë e kontrollit që ushtron publiku jo të gjitha të dhënat personale kodohen por vetëm ato sensitive. Të dhënat e tjera personale gjatë publikimit të vendimeve gjyqësore publikut të gjerë kodohen vetëm në rastet kur publikimi i tyre do të mund të ndikonte negativisht në jetën private, integritetin dhe interesat individuale të një personi.

Vlen të përmendet se gjatë kësaj periudhe që analizojmë, viti 2013, për herë të parë, në zbatim të rekomandimeve të lëna nga Misioni i Auditit të Brendshëm nga vitet e mëparshme, është përgatitur dhe hartuar rregullorja e brendshme e Gjykatës, e cila përcakton rregullat e organizimit e funksionimit të administratës gjyqësore në Gjykatën e Apelit Tiranë, duke përcaktuar strukturën organizative, kompetencat funksionale, si dhe të drejtat, detyrimet e përgjegjësitë e nëpunësve të administratës gjyqësore të kësaj gjykate.

Me urdhra të brendshëm, në funksion të një korrespondence të plotë me Ministrinë e Drejtësisë, Këshillin e Lartë të Drejtësisë, janë vendosur rregulla të qarta dhe janë parashikuar ceshtje civile (themeli apo administrative) të cilat ndjekin rradhën e gjykimit të përshpejtuar në një afat kohor më të shkurtër. Këto janë çështje me sensibilitet në publik ose me impakt social dhe në ndihmë të shtresave në nevojë (vërtetim fakti juridik, vjetërsitë në punë, paditë ndaj institucioneve të Sigurimeve Shoqërore, përfitim pensioni, etj.). Po kështu çështje të cilat vijnë në ndihmë të një gjykimi sa më të shpejtë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për të mos krijuar zvarritje në shkallët e gjykimit sic janë: pezullimi i gjykimit, pushimet, masa provizore, masa sigurimi etj. në përputhje me vendimet e KLD për gjykimin me procedure të përshpejtuar.

Çështjet e masave të sigurimit janë regjistruar e shqyrtuar brenda afatit (që parashikon K.Pr.Penale), gjë që siguron efikasitetin e veprimeve hetimore. I është dhënë përparësi gjykimit të çështjeve që kanë qënë të prishura dhe të kthyera për rigjykim në shkallë të parë dhe Gjykata e Apelit i ka gjykuar si shkallë e parë, si dhe çështjeve të cilat Gjykata e Lartë i kthen për rigjykim në Gjykatën e Apelit.

Zbatimi i vendimeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë ka qënë dhe do të jetë element i rëndësishëm në ushtrimin e veprimtarisë së Gjykatës së Apelit Tiranë. Ruajtja dhe **zbatimi i kriterëve të solemnitetit në gjykim**, veshja e gjyqtarëve me mantele, ruajtja e rregullit dhe qetësisë në seancë gjyqësore, veshja e detyrueshme e manteleve për avokatët e palëve dhe prokurorëve, si dhe veshje e sekretareve gjyqësore, së bashku në krijimin e rikostruktimit e sallave të gjykimit me dhoma këshillimi konform vendimeve të KLD-se, tregojnë qartë një tablo të plotë të mënyrës së gjykimit të çështjeve nga gjyqtarët me efikasitet të plotë dhe një gjykimi solemn aq të

mirepritur së pari për gjyqtarët dhe nënpunësit e Gjykatës së Apelit, po ashtu dhe për palët pjesëmarrëse në gjykim.

Gjithashtu në zbatim të vendimeve të KLD është siguruar dhe është rritur transparenca në shqyrtimin e çështjeve, respektimi i procedurave, respektimi i afateve, standartet në komunikim me palët, detyrimet për arsyetimet juridike, logjike, profesionale dhe gjyqsore të vendimeve përfundimtare.

Po në zbatim të vendimeve të KLD, në Gjykatën e Apelit Tiranë ka filluar procesi i vlerësimit të Gjyqtarëve për periudhën e caktuar nga KLD, 2007-2009.

Çmoj të evidentoj faktin se Gjykata e Apelit Tiranë ka qënë dhe është bashkëpunuese me Inpektoriatin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Ky bashkëpunim ka vazhduar gjatë gjithë kohës në lidhje me drejtimin e gjykatës dhe aplikimin në mënyrë sa më të detajuar të Vendimeve të KLD me fragmente të caktuara të funksionimit të institucionit. Gjithashtu dua të shtoj se ky bashkëpunim nuk duhet te vazhdojë vetëm në formën e letër-këmbimeve dhe kontrolleve por duhet te shtrihet me thellë në një bashkëpunim më efektiv institucional, zbatimin e vendimeve të KLD, diskutimeve që lindin lidhur me drejtimin e gjykatës, etj. Faktikisht e cmoj shumë të rëndësishme që inspektorët e KLD të cilët kanë qënë gjyqtarë dhe ruajnë të njëjtën cilësi, duhet te marrin pjesë në seminarët dhe trajnimet e vazhdueshme që organizon Shkolla e Magjistraturës në lidhje me disa tema të rëndësishme të cilat kanë të bëjnë me procedurën e gjykimit të çështjeve, mënyrën e arsyetimit të vendimeve etj, duke bërë rekomandimet e tyre. Ky bashkëpunim ndërmjet gjykatave dhe inspektorëve duhet te shihet në një këndvështrim më afatgjatë, duke u kthyer në një bashkëpunim më të frytshëm, pra jo vetëm në drejtim të kontrollit, pasi në këtë mënyrë i rritet performanca edhe vetë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Gjykata e Apelit Tiranë, ka patur dhe ka një bashkëpunim të frytshëm me **Zyrën e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor**. ZABGJ nga ana e saj ka qënë e gatshme dhe ka mbështetur Gjykatën tonë në iniciativat e saj, si dhe në zhvillimin e procedurave të prokurimit publik të zhvilluara këto dy vitet e fundit. Gjykata e Apelit Tiranë ka vlerësuar raportet e misionit të auditimit të mëparshëm dhe ka zbatuar me përpikmëri rekomandimet e specialistëve të auditit. Konkretisht në vlerësimin e fundit që Misioni i Auditimit të ZABGJ-së ka kryer, me krenari mund te evidentojme disa nga pikat e pasqyruara në raportin e kontrollit, ku theksohet se: këto dy vitet e fundit kemi një Gjykatë Apeli tjetër, në strukturë, përmbajtje dhe format shërbimi gjyqësor. Me standarte të larta shërbimi dhe sigurie, me asete publike -ndërtesa- të dedikuara për shërbime gjyqësore, si dhe e vetmja gjykatë me shërbim non-stop. Sipas raportit të auditit, të gjitha këto arritje gjatë periudhës 2 vjecare të fundit, janë shumë të madha



duke patur parasysh kohën e shkurtër brenda së cilës janë realizuar. Auditit ka vlerësuar nivelin dhe përgjegjësinë e treguar në drejtimin e gjykatës dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditit i mëparshëm, duke rritur nivelin e performancës së Gjykatës së Apelit Tiranë Tiranë. Misioni i Auditit ka theksuar se “kemi një gjykatë unike për nga funksionimi dhe shërbimi ndaj taksapaguesve, si dhe transparencë maksimale.”

Në gjykatën e Apelit Tiranë i është dhënë rëndësi të vecantë edhe **Sektorit të Teknologjisë së Informacionit** dhe për këtë i kemi kërkuar Ministrisë së Drejtësisë shtimin e numrit me të paktën një specialist IT.

Zyra e IT, pranë Gjykatës së Apelit Tirane, në veprimtarinë e punës së saj siguron vijueshmërinë në normalitet të procesit të punës, menaxhon sistemin informatik të proceseve gjyqësore dhe merr masat për realizimin e objektivave, me qëllim ruajtjen e standardeve teknike dhe sigurisë së informacionit, për vitin 2014 ka vendosur një sërë objektivash lidhur me :

- **Sigurinë e informacionit** – Zyra e IT do të bëjë një analizë për të krahasuar gjendjen aktuale të sigurisë së informacionit, krahasuar me standardin ISO27001.
- **Zhvillimin e Web Site-it** – në drejtim të përmirësimit të faqes së internetit të Gjykatës së Apelit Tiranë, duke e bërë atë lehtësisht të aksesueshme nga publiku i interesuar; Kryerjen e testeve të pavarura tremujore, depërtimit të sistemit të gjykatës për të siguruar standartet e duhura të sigurisë; Zhvillimin e nje Bibloteke digjitale, të instaluar në server në Gjykate dhe të përcaktimin e Definitive Library Softëare (DSL) ku ky softëare do të ruhet; Mirëmbajtjen dhe testimin e Sistemit Audio.

Aktualisht Specialistët tanë të IT janë duke asistuar edhe Gjykatën Administrative të Apelit me asistencë teknike, si pasojë e mungesës së përkohshme të stafit në stukturën organizative të kësaj gjykate. Është instaluar dhe vendosur në eficientë, rrjeti informatik i Gjykatës së Apelit Administrativ i është vënë në dispozicion shërbimi i internetit, në çdo zyrë, janë instaluar PC dhe është asistuar në plotësimin e specifikimeve teknike për të gjitha pajisjet elektronike që kjo gjykatë ka tenderuar.

* * *

Sic rezulton nga statistikat edhe gjatë këtij viti, Gjykata e Apelit Tiranë ka përballuar një numër më të madh çështjesh të regjistruara dhe të gjykuara në këto vitet e fundit. Sic vihet re, pavarësisht se në një raport jo shumë të theksuar, numri i çështjeve ka ardhur duke u rritur, duke e krahasuar atë me vitin 2012. Ka një rënie të lehtë të numrit të çështjeve civile të themelit si dhe të çështjeve penale të themelit, ndërkohë që vihet re

një rritje e çështjeve administrative dhe ankimeve kundër vendimeve të ndërmjetme, sic janë ato për sigurimin e padisë, pezullime e rivendosje në afat.

Ka një rritje të ndjeshme të çështjeve për vleftësimin e masave të sigurimit, duke e krahasuar me vitin 2012, ku rezultoi afërsisht të jetë dyfishuar ky numër çështjesh, nga 538 në 902. Këtu gjejmë rastin, të tërheqim vëmendjen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor dhe Prokurorisë, për vendosjen e masës së sigurimit “Arrest me burg”, për të gjitha rastet e konstatuara në kundërshtim me ligjin dhe Kodin e Procedurës Penale.

Në Kodin e Procedurës Penale dhe vendimeve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut parashikohet shprehimisht se masa e sigurimit “arrest me burg” vendoset kur është e papërshtatshme çdo lloj mase tjetër siguri ose për shkak të rrezikshmërisë së vecantë të veprës së të pandehurit. Vetëm dispozitat e K.Pr.Penale kanë përcaktuar edhe një kufi limit të masave të sigurimit në lidhje me masat e dënimit. Kodi penal me ndryshimet e fundit, ka parashikuar rrethana lehtësuese për masat e dënimit për të pandehurit në përshtatje me veprën që kryejnë për dënime nën 5 vjet burg. Në këto kushte gjykata në mungesë të rolit të saj aktiv në gjykimin e çështjes, ndodhet në kushtet e zbatimit të vetëm këtyre dispozitave ligjore dhe kurrsesi në tejkalim të tyre, të cilat sjellin mosperputhje me opinionin publik.

Në praktikën e shkuar të këtyre 20 viteve konstatohet lehtësisht se të gjitha procedimet penale ku janë gjykuar zyrtarë shtetit, i janë paraprirë me masat e sigurimit arrest në burg, të cilat kanë marrë rolin e dënimit ndaj tyre si në opinionin publik dhe në media. Kurse në fakt, praktika tregoi që në pjesën më të madhe kanë marrë pafajsi. Kështu që rol vendimtar këtu ka edhe media e cila në fakt krijon imazhin e gabuar që masa e sigurimit është edhe masa e dënimit për të pandehurin. Gjithsesi gjejmë vendin që t'i bëjë thirrje të gjithë aktorëve të drejtësisë, publikut të gjerë dhe medias, të cilët krijojnë opinione të gabuara për gjykatën, të reflektojnë duke patur parasysh se roli i gjykatës, në kontekstin e ndarjes së pushtetit, është ruajtja e ekuilibrit të një gjykimi mes palëve, të cilat mund të jenë shtet kundër individit ose mes vetë individëve. Pikërisht ruajtja e këtij ekuilibri është i domosdoshëm për ruajtjen e konceptit më të madh të ruajtjes së shtetit të së drejtës.

Përmbledhje e çështjeve të gjykuara për vitin 2013


Gjatë vitit 2013, në këtë gjykatë **kanë përfunduar me vendim përfundimtar gjithsej 6066 çështje.**

Konkretisht janë gjykuar :

- **2724 çështje civile themeli** (nga 3018 krahasuar me vitin 2012)
- **1201 çështje penale** (nga 1345 në vitin 2012)

- **160 çështje administrative**, (nga 110 në vitin 2012)
- **812 çështje me objekt sigurim padie, rivendosje në afat etj**, (nga 673 në vitin 2012)
- **250 çështje dhënie fuqi vendimeve të gjykatave të huaja** (nga 192 në vitin 2012)
- **902 çështje për vleftësimin e masave të sigurimit**, (nga 538 në vitin 2012)
- **4 çështje penale ushtarake**, (nga 19 në vitin 2012)

Më poshtë pasqyrohet një paraqitje grafike e këtyre të dhënave:




Volumi i çështjeve civile të shqyrtuara në Gjykatën e Apelit Tiranë, të ndara sipas rretheve, rezultojnë në të dhënat e mëposhtme:

Rrethi	Të shqyrtuara		Lënie në fuqi		Të cënuara	
	Civile	Penale	Civile	Penale	Civile	Penale
Tiranë	2401	885	1565	615	836	270
Krujë	71	96	40	70	31	26
Kurbin	52	79	40	50	12	29
Dibër	96	73	50	50	46	23
Mat	101	56	64	37	37	19
Gjithsej	2721	1189	1759	822	962	367


ÇËSHITJE CIVILE TË SHQYRTUARA GJATË VITIT 2013 SIPAS

RRETHEVE GJYQSORE.



ÇËSHITJET PENALE TË SHQYRTUARA GJATË VITIT 2013 SIPAS

RRETHEVE GJYQSORE.




Cilësia në Gjykim

Gjatë periudhës që analizojmë, konstatojmë së në Gjykatën e Apelit Tiranë nga totali **989** çështje civile, Pezullimi, Rivendosje në afat e Administrative, vetëm 6% e tyre janë ndryshuar nga Gjykata e Lartë dhe 2% janë prishur. Këto të dhëna tregojnë se cilësia e gjykimit në Gjykatën tonë është e lartë, në drejtim të zbatimit dhe interpretimit të drejtë të ligjit.

E njëjta gjë vlen edhe për çështjet penale dhe masave të sigurimit të gjykuara nga Gjykata e Apelit Tiranë, ardhur në vitin 2013 nga Gjykata e Lartë, ku 92% e çështjeve janë lënë në fuqi nga kjo gjykatë.

Më poshtë paraqiten të dhëna statistikore lidhur me cilësinë në gjykim.



Cilësia e gjykimit Çështje Civile, Pezullim, Rivendosje në afat, Administrative, gjykuar nga Gjykata e Apelit Tiranë, që kanë ardhur në vitin 2013 nga Gjykata e


Lartë

GJYQTARË	Gjithsej	Lënie ne fuqi	Prishur	Ndryshuar
Alaudin Malaj	50	50	-	-
Fiqirete Mullaj	16	16	-	-
Shkelqim Miri	34	33	1	-
Zamir Poda	79	73	5	1
Illir Toska	63	58	5	-
Edlira Petri	15	14	1	-
Gramoz Levanaj	40	39	1	-
Valdete Hoxha	35	35	-	-
Agron Papajani	71	71	-	-
Flutura Skenderi	84	77	6	1
Artur Kalaja	59	55	1	3
Dalip Bushi	68	64	4	-
Hysni Demiraj	81	78	3	-
Zegjine Sollaku	78	70	5	3
Edmond Gogo	9	8	1	-
Gjin Gjoni	71	68	2	1
Artan Broci	28	27	1	-
Lefter Jahaj	15	8	6	1
Metush Saraçi	21	21		
Genti Shala	26	26	-	-
Astrit Haxhialushi	-	-	-	-
Fatos Qato	26	23		3
Tom Ndreca	20	15	3	2
Evjeni Sinojmeri	-	-	-	-

Cilësia e gjykimit të çështjeve penale e masa sigurimi gjykuar nga Gjykata e Apelit Tiranë, që kanë ardhur në vitin 2013 nga Gjykata e Lartë

GJYQTARE	Gjithsej	Lenie ne fuqi	Prishur	Ndryshuar
Alaudin Malaj	4	4	-	-
Fiqirete Mullaj	5	5	-	-
Shkelqim Miri	14	14	-	-
Zamir Poda	11	11	-	-
Ilir Toska	9	9	-	-
Edlira Petri	3	3	-	-
Gramoz Levanaj	14	14	-	-
Valdete Hoxha	8	7	-	1
Agron Papajani	13	10	3	-
Flutura Skenderi	8	7	1	-
Artur Kalaja	1	1	-	-
Dalip Bushi	4	3	1	-
Hysni Demiraj	14	11	3	-
Zegjine Sollaku	2	2	-	-
Edmond Gogo	12	11	-	1
Gjin Gjoni	15	14	1	-
Artan Broci	9	9	-	-
Lefter Jahaj	54	48	6	-
Metush Saraçi	12	11	1	-
Genti Shala	37	36	1	-
Astrit Haxhialushi	40	37	3	-
Fatos Qato	41	35	1	5
Tom Ndreca	45	41	3	1
Evjeni Sinojmeri	6	6	-	-

Çështje penale e masa sigurimi gjykuar nga Gjykata e Apelit Tiranë, ardhur në vitin 2013 nga Gjykata e Lartë



Ngarkesa individuale e punës së gjyqtarëve gjatë vitit 2013

Ngarkesa e punës për secilin gjyqtar ka qënë relativisht e madhe. Janë gjykuar mesatarisht nga secili gjyqtar **245 çështje civile** apo **penale**. Por, ka edhe gjyqtar që kanë gjykuar mbi këtë mesatare, duke patur parasysh ardhjen e gjyqtarëve të rinj në muajin shtator të këtij viti.

Ngarkesa e punës për çdo gjyqtar nuk matet vetëm me numrin e çështjeve që ka patur secili për gjykim si relator.

Ajo është e plotë kur krahasohet me numrin e përgjithshëm të çështjeve që gjyqtari ka marrë pjesë në gjykim. Mesatarisht, çdo gjyqtar ka marrë pjesë në plotësim të trupave gjykues në mbi **400 çështje**.

EVIDENCA E NGARKESËS INDIVIDUALE TE PUNES SE GJYQTAREVE

VJETORE 2013

Emer mbiemer	Civile	Penale	Penale ushtarake	Dh.f. vend huaj	Masa sigurimi	Admini s-trative	Pez.Riv.	Gjithsej
Alaudin Malaj	90			2		2	21	115
Fiqirete Mullaj	170	2		23	13	10	60	278
Shkelqim Miri	183	2		14	58	9	52	318
Ilir Toska	142	3		11	27	8	35	226
Edlira Petri	138	3		12	66	11	36	266
Valdete Hoxha	164	2		14	44	9	57	290
Metush Saraçi	45	145		7	6	7	15	226
Hysni Demiraj	160	3		7	66	12	57	305
Gjin Gjoni	140	3		16	54	11	41	264
Flutura Skenderi	157	5		14	80	9	37	302
Artur Kalaja	150	2		10	38	9	56	265
Ervin Metalla	30	2		10	4	2	13	61
Agim Bendo	46	2		8	-	2	14	72
Zegjine Sollaku	169	1	1	15	44	10	47	287
Zamir Poda	164	2		12	72	4	45	299
Gramoz Levanaj	180	1		11	42	7	39	280
Fatmira Hajdari	40	3		10	4	2	16	75
Edmond Gogo	161	2		14	70	13	53	313
Ridvan Hado	31	2		10	52	3	10	108
Marie Qirjazi	46	2		7	4	3	14	76
Evgjeni Sinojmeri	115	3		10	45	4	39	216
Lefter Jahaj		222	1	-	5	-	-	228
Genti Shala		225	1	-	6	-	-	232
Shkelqim Mustafa		70		-	16	-	-	86
Fatos Qato		216		-	-	1	13	229
Agron Papajani	90	75	1	8	4	3	17	198
Astrit Haxhialushi		142			11	-	-	153
Tom Ndreca		67			-		-	67
Dalip Bushi	70			3	19	5	20	117
Artan Broci	41			5	35	5	6	93
Gjithsej	2724	1201	4	250	902	160	812	6066

Shpejtësia në Gjykim

Sipas të dhënave statistikore rezulton se shpejtësia në gjykim është në tregues të mirë. Por, ka dhe çështje që janë shqyrtuar në afate kohore mbi dy muaj dhe janë kryesisht ato çështje në të cilat është përsëritur hetimi gjyqësor. Shpejtësia e gjykimit për gjyqtarin llogaritet që nga momenti i shpalljes së çështjes për gjykim.

Shpejtësia në gjykimin e çështjeve:

Kohëzgjatja	Çështje Civile	Çështje Penale
Deri në 2 muaj	107	158
2 muaj deri 6 muaj	1242	956
mbi 6 muaj	1365	85



Mbetet ende shqetësuese zvarritja e qëllimshme e proceseve gjyqësore. Kështu, herë pas here palët në proces paraqesin dokumenta justifikuese (raporte mjeksore), që e detyrojnë gjykatën të shtyjë gjykimin e çështjes në një ditë tjetër. Kuptohet, që pas kësaj shtyrje shtohen edhe problemet e gjykatës, në njoftimin e palëve nominalisht, në veçanti, kur ka shumë palë në proces. Kjo shkakton vonesa në drejtim të dhënies së vendimit përfundimtar, por gjyqtarët e kësaj gjykate janë munduar të ruajnë parimin e moscënimit të gjykimit brenda një afati kohor të arsyeshëm. Në këtë mënyrë është imediate nevoja e një **ndërhyrje ligjore duke i dhënë gjykatës kompetencë për**

ndëshkimin e avokatit për pengim të drejtësisë. Nga praktika e përditshme në gjykatë, rezulton se në rastet kur janë plotësuar e zbatuar të gjitha rregullat procedurale në përputhje me ligjin, gjykimi është zhvilluar dhe ka përfunduar nga trupa gjyqësore në datën dhe orën e caktuar.

Përmbledhje e çështjeve të mbartura nga viti 2013 në vitin 2014

- 3057 Çështje civile
- 557 Çështje penale
- 467 Çështje Civile (pezullim, rivendosje, sigurim padie)
- 44 Çështje Administrative
- 12 Çështje Dhenie Fuqi vendimi të huaj
- 30 Çështje Masa Sigurimi
- 2 Çështje Penale Ushtarake

* * *

Administrimi i buxhetit të Gjykatës së Apelit Tiranë

Aktiviteti i Gjykatës financohet totalisht nga buxheti i shtetit dhe të ardhurat nga tarifat e shërbimit gjyqësor derdhen në buxhet. Ky institucion mban dhe ruan në përputhje me legjislacionin shqiptar, dokumentacion me aktivitet të shërbimit gjyqësor civile, penale, të aktivitetit ekonomik, të pasurisë publike dhe marrdhënieve të punës.

Dega e Buxhetit në Gjykatën e Apelit Tiranë për vitin 2013 është orientuar drejt ndërmarrjes së hapave për përmirësimin e sistemit të **Planifikimit** dhe **Manaxhimit** të fondit buxhetor në funksion të Zhvillimit të proceseve gjyqësore, dhe rritjes së cilësive të shërbimit ndaj publikut me qëllim rritjen e standarteve bashkohore, ku konsiston si më poshtë:

-Hartimi i Projekt –Buxhetit afatmesëm duke u mbështetur në nevojat e domosdoshme që kjo Gjykatë të arrijë dhe të plotësojë misionin e vet në të gjitha aspektet si në cilësi dhe transparencë të plotë.

-Ndarja e buxhetit të planifikuar për vitin kalendarik 2013 me zërat dhe nënzërat e tij në muaj dhe tremujor është bërë sipas prioriteteve dhe nevojave të domosdoshme që i gjithë procesi të zhvillohet në harmoni dhe normalisht.

-Menaxhimi i buxhetit është bërë në respektim të plotë të ligjit nr.10296 date 8.07.2010 (Per Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin), si dhe Udhëzimi nr.2 date 06.02.2012 të Ministrisë së Financave si dhe udhëzimet përkatëse të ardhura nëpërmjet Z.A.B.GJ. si zyrë mbikqyrëse ndaj zbatimit të buxhetit tonë në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Më poshtë paraqitet një analizë e hollësishme dhe në detaje për të gjithë zërat e buxhetit për vitin 2013 i përbërë nga katër zëra:

1-Fondi i pagave të personelit(Artikulli 600) i planifikua sipas organikes së Gjykatës të miratuar nga Ministria e Drejtësisë nr.126/1 date 30.03.2012 të planifikuar prej 71 punonjës, shkresa nr. 145/9 datë 12.03.2013 për shtesë 2 punonjës me kontratë 6 mujore për kolegjin zgjedhor, si dhe ndryshimet në organikë me 09.08.2013 për shtesë 11 punonjës ku numri total arrin në 82 punonjës, e ndryshuar me shkresën 2931 datë 01.11.2013, ku zbresim në totalin 80 punonjës ku fakti për vitin 2013 është 78 punonjës. Ky Fond është shpërndarë sipas ndryshimeve ligjore ardhur në dinamikë gjatë vitit 2013, i shprehur në **vlerë** Page plus Sigurime Shëndetësore:

Plani – **84.283.000** lekë

Fakti –**80.902.914** lekë

Realizimi i shprehur në përqindje 96 %

2-Fondi për shpenzimet operative (Artikulli 602)i përbërë në zërat

-**Materiale dhe shërbime zyre** si Letër, shtypshkrime, Tонера, kanceleri, Karburant, materiale rutinë të çastit emergjent:

-**Sherbime** si Energji, Uji, Telefona, Posta

-**Shpenzime transporti** si pjesë këmbimi dhe mirëmbajtje automjesh.

-**Shpenzime të tjera speciale** si Sherbim ruajtje me roje civile, Sherbim Avokatie, Ekzekutime vendime gjyqesore.

Të shprehura në vlerë:

Plani – **14.722.500** lekë

Fakti -**14.722.311** lekë

Realizimi i shprehur në përqindje 100 %

3-Fondi për Investime (Artikulli 231)i përbërë në zërat Rikonstruksion i Zyrave të Z.A.B.GJ, Motocikletë, Set zyre, Paisje elektronike për Personelin e Gjyqtarëve shtesë me 15.07.2013. Të shprehura në vlerë :

Plani – **15.600.000** lekë

Fakti –**15.533.216** lekë

Realizimi i shprehur në përqindje 99.57 %

Rikonstruksioni i godinës së Z.A.B.GJ. në përshtatjen e ambjenteve me Gjykatën e Apelit Tiranë u realizua sipas parashikimit brenda afateve kohore duke bërë të mundur plotësimin e kushteve normale për gjyqtarët e rinj të ardhur më 15.07.2013.

Duke analizuar shpenzimet buxhetore në veprimtarinë e gjykatës theksoj se fondi buxhetor i akorduar për vitin 2013 ishte i pa mjaftueshëm në shumicën e zerave si në Tонера, Karburant për Kaldajë, Pagesë Avokatësh, Energji, Ujë, mirëmbajtje sistemi ngrohje ftohje si dhe ekzekutim vendime gjyqësore. Për të gjitha këto nevoja, nga ana jonë i është bërë kërkesë zyrtare me shkrim Z.A.B.GJ-së, e si rezultat patëm shtesë fondi në muajin Nëntor 2013 në vlerën totale 300.000 lekë.

4-Realizimi i të ardhurave për vitin 2013 konsiston në zërat si më poshtë:

-Qera ambjenti e shprehur në vlerë 37.800 lekë shumë e cila i përket periudhës Tetor – Dhjetor vitit 2013, shumë e derdhur në buxhetin e shtetit.

-Të ardhurat nga Taksa e Pullave për vitin 2013 u realizuan në vlerën 2.826.000 lekë shumë e cila është derdhur në masën 100 %, për llogari të Degës Tatim Taksave, ku në zbatimin e Udhëzimit numër 1 datë **08.03.2013** të dalë nga **marrëveshja e Bordit të Z.A.B.GJ me Ministrin e Financave** u realizua akordimi dhe përdorimi nga ana e Gjykatës tonë 10 % e tyre në vlerë 205.200 lekë për likuidimin e faturave të pa likujduara të energjisë elektrike dhe të ujësjellësit për periudhën Tetor- Nëntor 2013.

Ndjekja dhe zbatimi i buxhetit është bërë në mënyrë rigoroze dhe i dokumentuar me dokumentet standarte financiare dhe kontable sipas Udhëzimeve të Ministrisë Financave. Dega e Buxhetit përgatit cdo muaj azhurnimin e dokumentacionit ekonomik financiar dhe kontabël duke dhënë informacionin në mënyrë shkresore sipas detyrimit ligjor si më poshtë :

- 1- Nënpunësit Autorizues(Kryetari i Gjykatës)
- 2- Z.A.B.GJ
- 3- Dega e Thesarit
- 4- Ministria e Drejtësisë
- 5- Dega Tatim TaksaveTiranë (taksën e pullave)
- 6- Ministrisë Ekonomisë (Qera Ambjenti)

Duke analizuar ndikimin e buxhetit në veprimtarinë e vitit 2013 kemi detajuar planifikimin e buxhetit për vitin 2014 duke rritur performancën në zbatimin korrekt dhe në cdo detaj të zerave të buxhetit në kryejën e detyrave të misionit.

Realizimi i Buxhetit krahasuar me vitin 2012 sipas zërave rezulton si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Buxheti i miratuar për vitin 2012	Buxheti i miratuar për vitin 2013	Raporti (%) Buxheti 2013/ Buxheti 2012
1	Shpenzimet e personeli	76.430.000	84.283.000	+10.2%
2	Shpenzimet operative	15,346,500	15.027.700	-2.1%
3	Investime	17.743,795	15.600.000	-12%
	TOTALI	109.520.295	114.910.700	+4.9%

* * *

Sfida dhe propozime për vitin 2014

Gjykata e Apelit Tiranë ka dëshmuar përgjegjësi morale dhe institucionale duke u fokusuar në një nga detyrat më të larta kushtetuese atë të mbrojtjes së pavarësisë së gjyqësorit. Në këtë gjykatë ne besojmë se pavarësia dhe paanshmëria arrihen vetëm duke ndjekur praktika efience dhe duke i kthyer ato në standarte. Ne besojmë me forcë se standartet e mirë administrimit të drejtësisë të vendosura në Gjykata e Apelit Tiranë me iniciativë të saj, këtë vit por edhe në vitet e tjera gjyqësore do të ndiqen me interes jo vetëm nga gjykatat e tjera por edhe nga të gjithë operatorët e sistemit të drejtësisë. Është provuar se praktikat mirë administrimit të drejtësisë me kalimin e kohës kthehen në standarte juridike dhe këto të fundit kthehen në tradita institucionale që janë aq të vyera për pavarësinë e pushtetit tonë gjyqësor.

Një nga sfidat e vitit gjyqësor 2014 ka të bëjë me **vendosjen e rregullave** të qarta e të detyrueshme për tu zbatuar **për plotësimin e trupave gjykues** dhe, këto rregulla propozoj të vendosen nga Kryetarët e Gjykatave në bashkëpunim me Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Konkretisht propozoj që në fillim të cdo viti, të përcaktohet për secilin gjyqtar të Gjykatës së Apelit Tiranë periudha dhe kolegji përkatës që do të plotësojë në rastet e mos formimit të trupit gjykues.

Një tjetër sfidë do të jetë edhe **transmetimi online i shortit elektronik në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë**, për t'a bërë caktimin e çështjeve një proces transparent 360 gradë. Kjo sepse besueshmëria e publikut te institucionet që ushtrojnë pushtetin gjyqësor nuk është vetëm një luftë për pavarësinë dhe

paanshmërinë por është edhe një luftë perceptimesh. Publiku duhet të perceptojë gjykatën si një institucion transparent e pavarur në mënyrë që të rikthehet besimi te institucionet.

Ekzistenca e pozicionit të **Ndihmësit Ligjor**, së paku për cdo trup gjykues është domosdoshmëri, jo vetëm për Gjykatën e Apelit Tiranë, por mendoj në përgjithësi për gjykatat të cilat kanë një volum të madh çështjesh për të trajtuar. Ndihmësi ligjor aq shumë i kërkuar jo vetëm nga ne, do të lehtësonte së tepërmi punën e gjyqtarit në ushtrimin e veprimtarisë së përditshme, duke lejuar që gjyqtari të përqendrohet në çështjen e vendimmarrjes. Kemi parasysh që në analizë të legjislacionit në fuqi që rregullon organizimin dhe funksionimin e gjykatave të shkallës së parë dhe të apeleve, të gjykatave administrative dhe të Gjykatës së Lartë konstatohet se në ligjin nr. 8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikohet në organikën dhe strukturën e kësaj gjykate pozicioni i ndihmësit ligjor. Po ashtu në nenin 6 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, parashikohet se gjyqtari i gjykatës administrative të shkallës së parë dhe të apelit, në veprimtarinë e tij ndihmohet nga ndihmësi ligjor. Prandaj jemi të mendimit që **është e domosdoshme ndërmarrja e një nisme ligjore nga ana e Ministrisë së Drejtësisë** për ndërhyrje në Ligjin nr. 9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku të përfshihet parashikimi mbi funksionimin e pozicionit të ndihmësit ligjor.

Është e vërtetë se perceptimi i gjyqësorit nga ana e publikut, kryhet më së shumti nëpërmjet mediave të shkruara dhe vizive, por mungesa e një **Urdhëri Profesional të Gazetarëve** e ka vështirësuar së tepërmi rolin e medias në përçimin dhe analizën cilësore e profesionale të punës së gjykatave. Ky boshllëk legjislativ i mungesës së Urdhërit të Gazetarëve ka krijuar jo pak probleme në lidhje me publikimin e informacioneve dhe të dhënave sensitive nga ana e mediave. Prandaj Gjykata e Apelit ka parashikuar në axhendën e saj një sërë iniciativash në këtë drejtim. Iniciativa e parë synon implementimin e një memorandum bashkëpunimi me përfaqësuesit e shoqatës së gazetarëve dhe të mediave, të cilët, duke u akredituar pranë institucionit tonë, do të kenë nga njëra anë një akses më të privilegjuar brenda Gjykatës së Apelit, dhe nga ana tjetër do të zotohen të zbatojnë disa rregulla deontologjike mbi publikimin e të dhënave sensitive të vendimeve.

Memorandumi do të ketë si qëllim primar të implementoj rregulloren e gjykatës në lidhje me marrëdhëniet me mediat vizive dhe të shkruara duke krijuar një regjistër themeltar të gazetarëve të akredituar pranë gjykatës së apelit të cilët do të kenë akses të privilegjuar me kërkesë të tyre dhe kundrejt pagesës të vendimeve. Në veçanti bashkëpunimi synon të sigurojë nga gazetarët zbatimin konkret të garancisë

kushtetuese të parimit të prezumimit të pafajësisë për çdo të pandehur dhe të mospublikimit të të dhënave sensitive për të miturit.

Media e shkruar dhe ajo vizive, apo dhe emisionet e ndryshme investigative, janë në një farë mënyre zëri i perceptimeve dhe opinionit publik dhe ky zë duhet të jetë sa më profesional e i njohur me konceptet juridike dhe rregullat e funksionimit të gjykatave. Kështu përpara se të bëhet publik një informacion duhet të verifikohet saktësia dhe besueshmëria e burimit nga është marrë. Nëse një informacion, me pasoja të drejtpërdrejta **për integritetin profesional dhe moral të një gjyqtari**, nuk është i bazuar në prova të qarta dhe të pakundërshtueshme, efektet e tij nuk kanë më vetëm një ndikim individual, por ato çënojnë rëndë drejtësinë dhe besimin e publikut në të. Prandaj sjellja me profesionalizëm nga ana e mediave kërkon një balancim të drejtë midis parimit të lirisë së shtypit, informimit të publikut nga njëra anë, dhe parimit themelor të prezumimit të pafajësisë, dhe respektimit të integritetit, nderit dhe dinjitetit të individit nga ana tjetër.

Problemi i ndërhyrjeve të paligjshme në vendimmarrjet gjyqësore është i përhapur dhe dobëson seriozisht besimin e publikut në sistemin gjyqësor. Gjyqtarët duhet të mbrohen e të gëzojnë një pavarësi reale dhe jo teorike, të vihen në gjendje të ushtrojë funksionet e veta të liruar nga format e presionit ekonomik , politik apo të sigurisë fizike për veten dhe familjet e tyre. Për të mbrojtur pavarësinë e gjyqtarëve është e nevojshme sot më tepër se kurrë që **shpërblimi ekonomik të jetë në proporcion të drejte me vështirësinë, rëndësinë e punës dhe rrezikshmërinë e detyrës që kryejn.**

Gjithashtu është thelbësore për të garantuar **paanshmërinë e gjyqtarëve**, që në marrëdhëniet me përfaqësuesit e të organit të prokurorisë dhe avokatisë të ruhet distance profesionale e nevojshme për të garantuar barazine e mjeteve procesuale.

Duhet theksuar se **reformimi i sistemit gjyqësor** nuk mund të bëhet kurrsesi me iniciativa populiste dhe as me deklarata mediatike.

Dështimi i iniciativave reformatore deri më sot ka ardhur si rezultat i cilësisë së dobët të teksteve normative, i natyrës së tyre fragmentare, dhe zgjedhjeve të nxituara të legjislatorit. Në reformat që vijojnë legjislatori duhet të marrë parasysh kontekstin e sistemit të së drejtës së huaj nga ku rregullat dhe modelet merren dhe duhet të vlerësojë me kujdes ndikimin që do të kenë këto ndërhyrje në ekuilibrin e përgjithshëm të sistemit të drejtësisë sonë.

Kështu në reformimin e sistemit gjyqësor duhen propozuar reforma organike të hartuara në atë mënyrë që zbatimi i tyre të jetë në harmoni me institutet e tjera dhe në veçanti në harmoni me parimin kushtetues së ndarjes së pushteteve, i cili nëpërmjet një

sistemi me pesha dhe kundërpesha garanton realisht pavarësinë e pushtetit gjyqësor nga dy pushtetet e tjera. Barrierat institucionale janë në vlerësimin tim pengesa kryesore që i kundërvihet zbatimit efektiv të reformave në fushën e drejtësisë. Prandaj Gjykata e Apelit do të jetë e angazhuar në bashkërenditjen e përfaqësuesve të institucioneve kryesore në lëmin e drejtësisë **rreth një tavoline pune** për të diskutuar në mënyrë argumentative dhe duke propozuar zgjidhje praktike për **problematikat e drejtësisë**. Këto iniciativa nuk bëjnë tjetër veç se ti japin një impuls pozitiv sistemit gjyqësor prandaj aspirata jonë për një sistem gjyqësor eficient i cili është në gjendje të përgjigjet në mënyrë të menjëherëshme zhvillimit ekonomik duhet të na bëj të ndalemi të reflektojmë mbi të ardhmen e sistemit tonë gjyqësorë.

Atribut i rëndësishëm i Gjykatës së Lartë është dhe unifikimi i praktikës gjyqësore nga ana e Kolegjeve të Bashkuara në ato raste kur nga praktika gjyqësore ka rezultuar se nga gjykatat me të ulta janë dhënë zgjidhje të ndryshme apo kontradiktore në lidhje me zbatimin apo interpretimin e normave të caktuara juridike. Vendimet e Kolegjeve të Bashkuara janë të detyrueshme për tu zbatuar nga të gjithë, duke patur kështu forcën e ligjit. Për këtë arsye, është e dëshirueshme dhe e pritshme nga gjyqtaret, në funksion të garantimit të uniformitetit të interpretimit të ligjit dhe standardizimit të dhënies së drejtësisë në sistemin gjyqësor, rritja e numrit të vendimeve unifikuese të Gjykatës së Lartë. Por nga ana tjetër, me qëllim që këto vendime të luajnë rolin e tyre orientues në praktiken gjyqësore, në shërbim të publikut të gjerë është e nevojshme që numri i gjyqtareve të Kolegjeve të Bashkuara që janë në unanimitet apo aderojnë me shumicën në vendim të jetë me i madh, dmth **vendimet unifikuese të jenë me shumicë të cilësuar**, ndryshim i cili ka nevojë të bëhet me ligj në kuadrin e reformave në sistemin e drejtësisë.

Ky fakt shpreh dhe përben tregues të qartë të një qëndrimi me të konsoliduar, unanim dhe me të pranueshëm të Kolegjeve të Bashkuara në drejtim të orientimit të përzgjedhur në procesin e interpretimit final të ligjit. Sa më i madh të jetë numri i gjyqtareve të shumicës aq më shumë konsistence, stabilitet dhe pranueshmeri prodhon vendimi unifikues në rendin juridik dhe veprimtarinë e gjykatave.

Gjithashtu kemi si objektiv afat shkurtër, përmirësimin e ambienteve në sallën e pritjes së publikut, duke krijuar një hapësirë të posaçme të pajisur me kompiutera dhe një bibliotekë ligjore elektronike, me qëllim ofrimin e një shërbimi shtesë në ndihmë të qytetarëve dhe profesionistëve që i drejtohen gjykatës, duke rritur kështu dhe aksesin e publikut tek Gjykata e Apelit Tiranë. Kjo është në kuadrin e iniciativave të reja që Gjykata e Apelit do të marrë, duke parë një nevojë të madhe në konsultimin dhe gjetjen e legjislacionit të Republikës së Shqipërisë. Biblioteka do të jetë e aksesueshme nga ana e gjyqtarëve, avokatëve dhe përfaqësuesve të tyre si dhe nga ana e publikut të gjerë nëpërmjet seksionit të **bibliotekës ligjore online** të faqja zyrtare e gjykatës.



Biblioteka ligjore do të përmbajë kodet e përditësuara, përmbledhjet e legjislacionit, jurisprudencën, koleksionet e fletoreve zyrtare dhe doktrinën juridike të legjislacionit shqiptar në formate të ndryshme elektronike. Për të mundësuar krijimin e bibliotekës ligjore Gjykata e Apelit do të nënshkruaj memorandume bashkëpunimi me Qendrën e Publikimeve Zyrtare dhe Shkollën e Magjistraturës.

Veprimtaria administrative e Gjykatës së Apelit ka patur qëllim jo vetëm marrjen e masave administrative për gjykimin në kohë dhe brenda afateve të arsyeshme të çështjeve civile dhe penale, por edhe bashkëpunimin ndërinstitucional në dobi të respektimit të ligjit, përfundimin në kohë dhe brenda afatit të arsyeshëm për çështje që kanë patur sensibilitet publik dhe ngritjen profesionale, pasurimin e dijeve të gjyqtarëve për çështje të larmishme të praktikës gjyqësore.

Megjithatë kjo është vetëm një pjesë e procesit dhe sfida shumë e rëndësishme shtrohet para nesh si gjyqësor. Ruajtja e besimit të publikut në administrimin e paanshëm dhe të pavarur të drejtësisë është një element jetik për funksion gjyqësor si dhe për shtetin e të drejtës. Humbja e besimit qoftë për shkak të inefikasitetit të tij ose, më në veçanti, për shkak të perceptimeve të një mungese të pavarësisë apo paanshmërisë nga ana e gjyqësorit është jashtëzakonisht e dëmshme për punën efektive të sistemit të drejtësisë.

Megjithatë këto arritje, mbetet ende shumë punë për të arritur rezultate të dukshme, të prekshme e cilësore në drejtim të rikthimit të besimit të publikut tek drejtësia dhe të përmirësimit të ndjeshëm të performancës së gjyqësorit shqiptar, duke patur vazhdimisht si pike referimi realizimin e objektivit madhor që gjyqësori shqiptar të konsolidohet me tëj e të funksionojë sipas standarteve me të përparuar të vendeve të Bashkimit Europian ku aspirojmë të aderojmë.

* * *

Aktivitetet të zhvilluara gjatë vitit 2013

Një rol të veçantë në administrim dhe funksion të gjykatës, ka patur pikërisht përfaqësimi i saj në kuadrin e rritjes së transparencës, besimit të publikut të gjyqësorit. Në fokus të gjykatës ka qenë rritja e angazhimit profesional të gjyqtarëve nëpërmjet aktiviteteve të shumta që ka marr pjesë gjykata gjatë vitit 2013. Ndryshe nga vitet e mëparshme, ku trupat gjyqësore kanë hezitur të përfshihen në këto aktivitete, duke sjellë një lloj izolimi të institucionit, këtë vit janë zhvilluar seminare, trajnime dhe konferenca, takime shumëpalëshe dhe tryeza të rrumëbullakta, me qëllimin e vetëm të hapjes të kësaj pjesë të intelektualëve të vendit në krijimin e imazhit pozitiv.

Gjatë gjithë muajit Mars 2013 në Gjykatën e Apelit Tiranë është zhvilluar trajnimi nga projekti JUST i USAID, për përdorimin e sistemit audio i cili u vu në funksionim në muajin prill 2013. Ky trajnim është zhvilluar me të gjitha sekretaret gjyqësore të Gjykatës së Apelit Tiranë si dhe gjyqtarët, duke u organizuar në grupe pune të veçanta. Gjyqtarët e kësaj gjykate kanë marrë pjesë në mënyrë sistematike në trajnimet e organizuara nga Shkolla e Magjistraturës.

Në datat **15-16 maj 2013** u zhvillua aktiviteti me teme: **“Trashëgimia me testament (Kontradiktat midis vullnetit të testatorit dhe kushteve ligjore sipas Kodit Civil.; pavlefshëmria e testamentit, probleme teorike dhe të praktikës gjyqësore; Çështje ligjore dhe praktike në lidhje me rezervën ligjore.)”**.

Në datën **28 maj 2013** u zhvillua aktiviteti me temë: **“Padi të për mbrojtjen e të drejtës së trashëgimisë, Padi për kërkimin e trashëgimit. Kthimin e pasurisë trashëgimore. Njohjen e trashëgimtarit. Rastet dhe kushtet e ngritjes së tyre.”**

Gjykata e Apelit Tiranë në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional ka qënë e gatshme dhe ka bashkëpunuar me Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, në organizimin e **Konferenceshencore Nderkombetare me temë: “100 Vjet Drejtësi dhe Doktrinë, më datë 9 Maj 2013.** Kjo Konferencë u zhvillua gjithashtu në bashkëpunim dhe me Institutin Max Planck për të Drejtën e Krahasuar dhe Nderkombetare Private, Hamburg, Universitetin e Romës “Sapienza”, Universitetin e Stambollit, Turqi. Konferenca u organizua në kuadrin e 100 vjetorit të ditës së Drejtësisë me synimin për të rritur kapacitetin kërkimor shqiptar, analizimin e problematikave bashkëkohore në drejtësi që i dalin Shqipërisë në kuadër të procesit të integritimit Evropian, forcimin e bashkëpunimit me Institute prestigjioze kërkimore të huaja si dhe mbështetjen e nxitjen e mëtejshme të shkëmbimit të eksperiencave midis njësive të ndryshme kërkimore shkencore.

Gjykata e Apelit Tiranë duke vlerësuar rëndësinë e trajnimit të vazhdueshëm, **ka mbështetur Shkollën e Magjistraturës e cila në bashkëpunim me Assist Impact organizoi në ambientet e kësaj gjykate aktivitetin me temë: “Falimenti”, ne dt.6 maj 2013**, ku morën pjesë të gjithë gjyqtarët e Gjykatës sonë, nën drejtimin e Eksperteve: Yair Baranes dhe Vangjel Kosta.

Kolegji Zgjedhor si pjesë e Gjykatës së Apelit Tiranë, ka marrë pjesë dhe mbështetur seminarin **“Krijimi i Burimeve për Demokraci, Qeverisje dhe Zgjedhje, (BRIDGE)”**, i organizuar nga UNDP dhe Gjykata e Apelit Tirane, nga data 27-30 Maj 2013. Të pranishëm në këtë seminar ishin Znj. Zineb Touimi-Benjelloun, Koordinatorë e Agjensive të Kombeve të Bashkuara dhe Përfaqësuese e Përhershme e programit të

Zhvillimitë Kombeve të Bashkuara (UNDP), Kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve znj. Lefterije Luzi (Lleshi), Anëtarët e Kolegjit Zgjedhor, znj. Yesim Oruc, Drejtore e Zyrës së UNDP në Shqipëri dhe përfaqësues të partive politike dhe organizatave ndërkombëtare që operojnë në fushën e zgjedhjeve. Fokusi i këtij seminari ishin mosmarrëveshjet zgjedhore dhe synonte të ndihmonte Kolegjin Zgjedhor, KQZ dhe aktorët e tjerë të rëndësishëm në fushën e zgjedhjeve për zgjidhjen e debateve zgjedhore, menaxhimin dhe zgjidhjen e ankesave zgjedhore, sfidat lidhur me procedurat votimit e të tjerë.

Këtë vit janë zhvilluar disa trajnime të rëndësishme me partnerët ndërkombëtar OPDAT që kanë implementuar sistemin e regjistrimit audio në gjykatat shqiptare. Për këtë qëllim u zhvillua **në datat 13-14-15 Nëntor 2013 Konferenca e Tretë Rajonale të Lidërshiptit në Gjiqësor** Në këtë Konferencë u evidentuan pengesat praktike në funksionimin e sistemit audio në gjykatën tonë.

Gjykata e Apelit ka ndërrmarë me iniciativë të saj rekomandimet për zgjidhjen e këtyre problemeve praktike, dhe në veçanti ka ndjekur një politikë informimi me gjyqtarët, administratën gjyqësore, qytetarët dhe profesionistët që i drejtohen gjykatës mbi rregullat që duhen ndjekur për funksionimin e tij optimal. Në këtë kuadër Gjykata e Apelit ka bërë përpjekje për standartizimin konkret të procedurave. Të gjithë pjesëmarrësit në këtë sistem kenë një përmbledhje të shkruar të detyrave të tyre. Janë hartuar disa kritere standart, si për procedurën që duhet të ndiqet gjatë kryerjes së një funksioni në sistemin e regjistrimit dhe po kështu një manual informimi mbi procedurat e zgjidhjeve të problematikave më të shpeshta të hasura.

Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë, kanë marr pjesë në **Simpoziumin per Etiken Gjyqesore organizuar nga Zyra e OPDAT** pranë Ambasades se Sh.B.A-ve ne Tirane, ne bashkepunim me Konferencen Gjyqesore Kombetare dhe Unionin e Gjyqtareve te Shqiperise. Simpoziumi u zhvillua ne datat 5- 7 nentor ne Tirane dhe ne te morën pjese gjyqtare nga te tre nivelet e gjyqsorit, si dhe perfaqesues te institucioneve te tjera te sistemit te drejtesisesi inspektorë nga KLD, përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, profesorë të Shkollës së Magjistraturës, Këshilltarë të Presidentit të Republikës,etj.

Në këtë simpozium u diskutuan çështje që përfshinin: besimin e publikut tek gjyqesori, ndikimet e papershtatshme mbi gjyqtarin dhe sistemin gjyqesor, zbatimin aktual dhe te ardhmen e Kodit te Etikes Gjyqesore, standardet nderkombetare per gjyqesorin, rolin e shoqatave te gjyqtareve, etj.

Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë në këtë simpozium ka trajtuar temen: **Ndikimet e papërshtatshme mbi gjyqtarin dhe sistemin gjyqësor**; Format e ndikimeve të papërshtatshme; Strukturat ose segmentet brenda sistemit gjyqësor që janë

vecanërisht të prekshëm nga ndikimet e papërshtatshme; Perceptimi i ndikimeve të papërshtatshme.

Gjykata e Apelit Tiranë është përfaqësuar gjithashtu edhe në seminarin trajnues të organizuar nga zyra OPDAT e Ambasadës Amerikane në Tiranë, me temë: “Shkrimi i vendimeve gjyqësore”, në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, zhvilluar në datat 10- 11 dhjetor në Tiranë. Në këtë seminar morën pjesë 31 pjesëmarrës duke përfshirë gjyqtarë të shkallës së parë dhe apelit, ndihmës ligjorë të Gjykatës së Lartë dhe Apelit Tiranë, si dhe student të Shkollës së Magjistraturës. Disa nga çështjet që u diskutuan ishin: përgatitja për të shkruar, organizimi dhe shkrimi i një vendimi gjyqësor, vetë-redaktimi dhe redaktimi gjuhësor, çështjet e etikës në shkrimin e vendimeve me gjyqtarë të tjerë, etj.

Vlen të përmendet se të gjitha këto aktivitete të zhvilluara gjatë vitit 2013, Kryetari i Gjykatës së Apelit Tiranë, përkrah axhendës së tij të përditshme, ka qenë i angazhuar maksimalisht si në pjesëmarrje ashtu edhe në mbajtjen e fjalës përshëndetëse dhe referate të ndryshme, të cilat janë të pasqyruara në faqen e internetit të gjykatës, **me qëllim rritjen e transparencës, performancës, nivelit shkencor dhe juridik të Gjykatës se Apelit Tiranë.**

Përfundimisht duke ju falenderuar për vemendjen e treguar, u munduam t’ju bëjmë një përmbledhje të thjeshtë të të gjithë veprimtarisë së Gjykatës së Apelit Tiranë për vitin që shkoi dhe njëkohësisht ju premtoj se tashmë vitet e ardhshme do të tregojnë se kjo gjykatë do të jetë në nivelin e duhur dhe do të zbatojë paraprakisht dhe në mënyrë të pavarur sic ka vepruar në këto dy vjet rekomandimet e Komisionit Evropian në lidhje me arritjen e standartit evropian në këtë gjykatë.

Më lejoni gjithashtu të nderuar, ta mbyll fjalën time, duke kujtuar se pak ditë më parë, u nda nga jeta kolegu dhe miku yne i dashur, i ndjeri Agron Papajani. Goni është pjesë e suksesit dhe këtyre arritjeve që përmenda sot, por do të mbahet mend vecanërisht për frymën e bashkëpunimit dhe mirëkuptimit që kishte me ne të gjithë, sidomos për aftësitë e tij profesionale. Në kujtim të tij, sot ju ftoj ju, anëtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë, anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe aktorët e tjerë të drejtësisë që të harrojmë dhe të lëmë mënjanë të shkuarën, duke filluar një etapë re bashkëpunimi mes kolegëve në shërbim të sigurisë së jetës, sigurisë së profesionit dhe dhënies së drejtësisë !

Ju faleminderit !

Kryetari i Gjykatës

ALAUDIN MALAJ